

PAULO COELHO

ALEF

ROMAN

BOTIMET TOENA

Libra nga Paulo Coelho,
prej Shtëpisë Botuese TOENA

- Alkimisti
- Mali i pestë
- Veronika vendos të vdesë
- Djalli dhe zonjusha Pym
- Pelegrini i Kompostelës
- Manuali i luftëtarit të dritës
- Njëmbëdhjetë minuta
- Zahiri
- Shtriga e Portobelos
- Buzë lumit Piedra u ula dhe qava
- Fitimtari është i vetëm
- Brida
- Alef

Paulo COELHO

ALEF

■ *roman* ■

Përktheu nga spanjishtja

Edlira HOXHOLLI

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2013

Titulli në original: *Paulo Coelho, Aleph*

Ky libër u botua sipas marrëveshjes me
Sant Jordi Asociados Agencia Literaria S.L.U., Barcelona (Spain).
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Botuese: Irena Toçi

Redaktoi: Bashkim Shehu
Korrektore letrare: Majlinda Bami, Olta Canka
Përkujdesja grafike: Albana Kura
Kopertina: Lavdie Cenmurati

ISBN 978 - 99943 - 1 - 908 - 4

© Paulo Coelho, 2010
(www.paulocoelho.com)

© Në gjuhën shqipe: Shtëpia Botuese Toena

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: ++355 4 22 40 116; ++355 4 22 58 893

Fax: ++355 4 22 40 117

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

*O Marie, e ngjizur pa mëkat,
lutu për ne që vijmë te Ti.
Amin!*

Një burrë nga një familje fisnikësh shkoi
në një vend të largët
që të kurorëzohej mbret dhe të kthehej sërish.

Luka, 19, 12

*Për J., që më mban në lëvizje,
për S. J., që vazhdon të më mbrojë,
dhe për Hilalin, për faljen
që dha në kishën e Novosibirskut.*

“Diametri i *Alef*t mund të ishte dy ose tre centimetra,
por e gjithë hapësira kozmike ndodhej në të,
me tërë madhësinë e saj.
Çdo gjë [...] ishte një mori e pafundme gjërash,
sepse unë e shihja nga të gjitha pikat e Gjithësisë.”

JORGE LUIS BORGES, *Alef*

“Unë s’mund të shoh dhe ti i di të gjitha.
Por edhe kështu, jeta ime nuk shkon dëm,
sepse e di që do takohemi sërish
në ndonjë përjetësi hyjnore.”

OSCAR WILDE

Mbret i mbretërisë sime

Jo!

Një ritual tjetër? Një ndjellje tjetër e forcave të padukshme për t'u shfaqur në botën e dukshme? E ç'lidhje ka kjo me botën ku jetojmë sot? Të rinjtë mbarojnë universitetin dhe nuk gjejnë punë. Të moshuarit dalin në pension pa asnjë grosh në xhep. Të rriturit nuk kanë kohë për të ëndërruar; që nga teta e mëngjesit deri në pesë të pasdites luftojnë për të mbajtur familjen, për të paguar shkollën e fëmijëve, duke u përballur me atë që të gjithë e njohim me emrin “realitet i vështirë”.

Bota nuk ka qenë asnjëherë kaq e përçarë sa tani: luftëra fetare, gjenocide, mungesë respekti për planetin, krizë ekonomike, depresion, varfëri. Të gjithë kërkojnë rezultate të menjëhershme për të zgjidhur të paktën disa nga problemet e botës, ose të jetës së tyre private. Por gjërat duken gjithnjë e më të errëta sa më tepër që i afrohemi së ardhmes.

Po unë, ç'bëj kështu, duke u përpjekur të eci përpara në një traditë shpirtërore, rrënjët e së cilës i përkasin një të kaluar shumë të hershme, larg çdo sfide të çastit të tanishëm?

Bashkë me J-në, të cilin e quaj mësuesin tim, ndonëse filloj të kem dyshimet e mia në lidhje me këtë, ecim drejt lisit të shenjtë, që ndodhet aty prej më shumë se pesëqind vjetësh, duke vështruar mospërfillës agonitë e njerëzimit me shqetësimin e vetëm të lëshojë gjethet përdhe në dimër për t'i rikuperuar në pranverë.

Nuk dua të shkruaj më për lidhjen që kam me J-në, udhërrëfyesin tim për te Tradita. Kam dhjetëra ditare të mbushur me shënime nga bisedat tona, të cilët nuk i rilexoj asnjëherë. Qysh kur e njoha në Amsterdam, më 1982, mësova dhe çmësova njëqind herë të jetoja. Kur J. më tregon diçka të re, mendoj se ndoshta ky do të jetë hapi përfundimtar, do t'më çojë në majën e malit, nota që përlijt krejt simfoninë, fjala që ngërthen librin. Po kaloj një periudhë euforie, që pak nga pak po zhduket. Disa gjëra mbeten përgjithmonë, por pjesa më e madhe e ushtrimeve, e praktikave, e mësimëve, zhduken në një vrimë të zezë. Ose, të paktën, kështu ngjason.

Toka është e lagur, ma merr mendja se me të bërë edhe disa hapa, atletet e mia, të lara me kujdes dy ditë më parë, do të mbushen përsëri me baltë, sado i kujdesshëm që të jem. Kërkimi im për urtësi, paqen e shpirtit dhe njohjen e realiteteve të dukshme dhe të padukshme është kthyer në një rutinë që nuk jep më rezultat. Kur isha njëzet e dy vjeç, fillova t'i kushtohem të mësuarit të magjisë. Përshkova rrugë të shumta, eca buzë greminës vite me radhë, kam rrëshqitur dhe jam rrëzuar, kam hequr dorë dhe kam

rifilluar. Mendoja se kur të isha pesëdhjetë e nëntë vjeç do të isha pranë Parajsës dhe paqes absolute, që besoja se e shihja në buzëqeshjet e murgjve budistë.

Përkundrazi, duket se jam më larg se kurrë. Nuk kam paqe, herë pas here hyj në konflikte të mëdha me veten time, që mund të zgjasin me muaj. Dhe momentet kur zhytem në një realitet magjik zgjasin vetëm disa sekonda. Aq sa për ta ditur që kjo bota tjetër ekziston, dhe mjaftueshëm sa për të më lënë të zhgënjyer ngase nuk jam i aftë t'i përthith të gjitha ato që mësoj.

Arrijmë.

Kur të mbarojë rituali, do të flas shtruar me të. Të dy vëmë duart mbi trungun e lisit të shenjtë.

J. thotë një lutje sufi:

- O Zot, kur dëgjoj me vëmendje zërat e kafshëve, zhurmat e pemëve, shushurimën e ujit, cicërimën e zogjve, uturimën e erës, apo gjëmimin e një bubullime, gjej në to një dëshmi të harmonisë Tënde; ndiej që Ti je pushteti i epërm, gjithëdija, urtësia e epërme, drejtësia e epërme.

- O Zot, të njoh në provat që po kaloj. Lejo, o Zot, që kënaqësia Jote të jetë kënaqësia ime. Që unë të jem gëzimi Yt, ai gëzim që ndien prindi për fëmijën. Dhe që unë të kujtohem për Ty me paqe dhe vendosmëri, madje edhe kur e kam të vështirë të të them Të dua.

Zakonisht, në këtë çast, unë duhej të ndieja – për një fraksion sekonde, por kjo më mjaftonte - Praninë Unike që lëviz Diellin dhe Tokën dhe i mban yjet në vendin e tyre. Por sot, nuk dua të flas me Universin; më mjafton që njeriu pranë meje të më japë përgjigjet që më duhen.

Ai heq duart nga trangu i lisit, dhe unë bëj të njëjtën gjë. Më buzëqesh dhe i buzëqesh. Nisemi, në heshtje dhe pa u ngutur, për në shtëpinë time, ulemi në ballkon dhe pimë një kafe, ende pa folur.

Vështroj pemën gjigante në mes të kopshtit, me një shirit përreth trungut, i vënë aty pas një ëndrre. Jam në fshatin Shën Martin, në Pirenejtë francezë, në një shtëpi të cilën jam penduar që e kam blerë; ajo arriti të më robëronte, duke kërkuar praninë time sa herë që të ishte e mundur, sepse ka nevojë për dikë që të kujdeset për të që të mbajë gjallë energjinë e saj.

- Nuk arrij të rritem më, - them, duke rënë përherë në grackën e të qenit i pari që thyen heshtjen. - Mendoj se kam arritur kufirin tim.

- Sa interesante. Unë gjithmonë jam përpjekur t'i gjej kufijtë e mi dhe ende nuk kam mundur të arrij deri atje. Por universi im nuk bashkëpunon shumë me mua, vazhdon të rritet dhe nuk më ndihmon që ta njoh tërësisht, - më provokon J.

Po tregohet ironik. Megjithatë unë vazhdoj.

- Për çfarë ke ardhur sot këtu? Të përpiqesh të më bindësh se e kam gabim, si përherë. Thuj çfarë të duash, por ta dish se fjalët e tua nuk do të ndryshojnë asgjë. Nuk jam mirë.

- Pikërisht për këtë kam ardhur sot, këtu. E parandjeva se çfarë po ndodhte, prej kohësh. Po gjithmonë ka një moment të saktë për të vepruar, - pohon J., duke marrë një dardhë nga tryeza dhe duke e sjellë nëpër duar.

- Po të kishim folur më parë, ende nuk do të ishe pjekur. Po të kishim folur më vonë, ti do të ishe kalbur,

- i jep një të kafshuar frutës, duke u kënaqur me shijen e saj. - E përsosur. Ky është çasti i duhur.

- Kam shumë dyshime. Dhe më të mëdhatë janë dyshimet e mia mbi besimin, - ngulmoj.

- Shkëlqyeshëm. Dyshimi e shtyn njeriun përpara.

Si gjithmonë, përgjigje të goditura dhe figura të goditura, por sot nuk vlejnë.

- Do të them çfarë ndien, - vazhdon J., - ti ndien se të gjitha ato që ke mësuar nuk kanë hedhur rrënjë, se je në gjendje të kridhesh në universin magjik, por jo të rrish i zhytur në të. Se mundet që kjo të mos jetë veçse një fantazi e madhe e krijuar nga qenia njerëzore për të larguar frikën nga vdekja.

Pyetjet e mia janë më të thella: janë dyshime mbi besimin. Jam i sigurt vetëm për një gjë: se ekziston një univers paralel, shpirtëror, që ndërhyt në botën ku jetojmë. Pastaj, gjithçka tjetër - librat e shenjtë, zbulesat, udhëzuesit, manualët, ceremonitë - të gjitha këto më duken absurde. Dhe, më e keqja është se nuk kanë efekte të përhershme.

- Do të të tregoj çfarë ndjeva unë, - vazhdon J. - Kur isha i ri, më magjepsnin të gjitha gjërat që mund të më ofronte jeta dhe mendova se isha i aftë t'i arrija të gjitha. Kur u martova, m'u desh të zgjidhja një rrugë të vetme, sepse duhej të mbaja gruan që dua dhe fëmijët. Në moshën dyzetepesëvjeçare, kur tashmë isha bërë një drejtues shumë i suksesshëm, pashë se fëmijët ishin rritur dhe ikën nga shtëpia dhe mendova se, që nga ai çast, gjithçka do të kthehej në përsëritje të asaj që kisha përjetuar. Aty filloi kërkimi im shpirtëror. Jam njeri i disiplinuar dhe iu përkushtova atij me të gjitha forcat e mia. Kalova periudha

entuziazmi dhe mosbesimi, derisa arrita në fazën që (ti) po jeton sot.

- J., me gjithë përpjekjet që kam bërë, nuk mund të them: “Jam më pranë Zotit dhe vetes sime”, - them, disi i acaruar.

- Kjo ndodh sepse ti, ashtu si të gjithë njerëzit e planetit, mendove se koha do të të mësonte t’i afroheshe Zotit. Po koha nuk të mëson; vetëm të krijon një ndjesi lodhjeje dhe plakjeje.

Lisi tani dukej sikur po më vështronte. Duhej të kishte më shumë se katër shekuj dhe gjithçka që kishte mësuar ishte të qëndruarit në të njëjtin vend.

- Pse erdhëm t’i bënim një ritual këtij lisi? Si na ndihmon kjo për t’u bërë qenie njerëzore më të mira?

- Sepse njerëzit nuk bëjnë më rituale te lisat. Dhe, duke vepruar në një mënyrë që mund të duket absurde, kjo prek diçka thellë në shpirtin tënd, në pjesën e tij më të vjetër, më të afërt me zanafillën e gjithçkaje.

Është e vërtetë. Pyeta për atë që e dija dhe mora përgjigjen që prisja. Duhet të përfitoj më mirë nga çdo çast pranë tij.

- Është koha për të ikur prej këtej, - tha J. papritur.

Vështroj orën. I shpjegoj se aeroporti është pranë, se mund ta vazhdojmë bisedën edhe pak.

- Nuk e kam fjalën aty. Kur i kalova këto që po jeton ti tani, e gjeta përgjigjen te diçka që kish ndodhur para se të lindja unë. Pikërisht këtë po të sugjeroj të bësh.

Rimishërimin? Gjithmonë më kishte bindur që të mos i vizitoja jetët e mia të kaluara.

- Unë jam kthyer në të kaluarën. Mësova vetë, para se të të njihja. Kemi folur për këtë; pashë dy

rimishërime: një shkrimtar francez në shekullin e nëntëmbëdhjetë dhe një...

- Po, e di.

- Kam bërë gabime që nuk mund t'i ndreq tani. Dhe më the që mos ta bëja më, sepse vetëm sa do të ndihesha edhe më fajtor. Të udhëtosh në jetët e kaluara është një lloj si të hapësh një vrimë në dysheme dhe ta lësh zjarrin e katit të poshtëm të ndezë të tashmen.

J., ua hedh atë që ka mbetur nga dardha zogjve të kopshtit dhe më vështron i acaruar:

- Mos thuaj marrëzira, të lutem. Mos më bëj të mendoj se s'ke mësuar asgjë në këto njëzet e katër vjet që kemi kaluar bashkë.

Po. E di për çfarë po flet. Në magji - dhe në jetë - ekziston vetëm çasti aktual, TANI. Koha nuk matet siç llogaritet largësia mes dy pikave. "Koha" nuk kalon. Qenia njerëzore e ka shumë të vështirë të përqendrohet në të tashmen; gjithmonë mendon për atë që ka bërë, si mund ta kishte bërë më mirë, në pasojat e veprimeve të veta, pse nuk u soll si duhej të ishte sjellë. Ose shqetësohet për të ardhmen, çfarë do të bëjë nesër, çfarë vendimesh duhet të marrë, çfarë rreziku e pret, si të shmangë atë që nuk do dhe si të arrijë atë që gjithmonë ka ëndërruar.

J. i kthehet bisedës.

- Kështu pra, tani dhe këtu, fillon të pyesësh veten: a ka vërtet diçka që nuk shkon? Po. Por në këtë çast kupton gjithashtu se mund ta ndryshosh të ardhmen tënde duke e sjellë të kaluarën në të tashmen. E kaluara dhe e ardhmja ekzistojnë në kujtesën tonë. Por momenti i tanishëm është përtej kohës: është

përjetësia. Hindutë përdorin fjalën “karma”, duke mos pasur një term më të saktë. Por koncepti është shpjeguar keq: nuk janë veprimet e tua në jetën e mëparshme ato që do të ndikojnë të tashmen. Janë veprimet e së tashmes ato që do të çlirojnë të kaluarën dhe, logjikisht, do të ndryshojnë të ardhmen.

- Domethënë...

Bën një pauzë, gjithherë e më i acaruar sepse nuk po arrij të kuptoj atë çka po përpiqet të më shpjegojë.

- Nuk ka kuptim të rrish këtu duke përdorur fjalë që nuk duan të thonë asgjë. Provo! Është koha që *ti* të dalësh prej këtej. Të rifitosh mbretërinë tënde, të zvetënuar nga rutina. Mjaft më me përsëritjen e të njëjtit mësim, nuk do të të mësojë asgjë të re.

- Nuk është çështje rutine. Unë jam i palumtur.

- Kjo quhet rutinë. Ti mendon se ajo ekziston ngaqë je i palumtur. Njerëz të tjerë jetojnë në varësi të problemeve të tyre dhe detyrimisht e kalojnë jetën duke folur për to: probleme me fëmijët, me burrin, në shkollë, në punë, me miqtë. Nuk ndalen të mendojnë: jam këtu. Jam pasojë e gjithçkaje që ka ndodhur dhe e asaj që do të ndodhë, por jam këtu. Në qoftë se kam bërë diçka të gabuar, mund ta ndreq, ose të paktën të kërkoj falje. Në qoftë se kam bërë diçka të drejtë, kjo më bën të jem më i lumtur dhe më i lidhur me të tanishmen.

J. merr frymë thellë para se të përfundojë.

- Tani nuk je këtu. Ka ardhur koha të ikësh për t'u kthyer përsëri në të tashmen.

Pikërisht kësaj po i trembesha. Kishte ca kohë që më linte të kuptoja se kishte ardhur çasti që t'i

kushtohesha rrugës së tretë të shenjtë. Megjithatë, jeta ime kishte ndryshuar shumë që nga viti i largët 1986, kur pelegrinazhi në *Santiago de Kompostela* më bëri të përballesha me fatin tim, ose me “planin e Zotit”. Tre vjet më vonë, bëra Rrugën e Romës, në krahinën ku ishim tani; një proces i dhimbshëm, i lodhshëm, që më detyroi të kaloja shtatëdhjetë ditë duke bërë në mëngjes të gjitha absurditetet që kisha parë në ëndërr natën e mëparshme. Mbjaj mend që ndenja katër orë në një stacion autobusi, pa ndodhur asgjë me rëndësi.

Qysh atëherë, i bindesha me disiplinë gjithçkaje që ma kërkonte puna. Në fund të fundit, ishte zgjedhja ime dhe bekimi im. Pra, fillova të udhëtoja si i çmendur. Mësimet e mëdha që kam nxjerrë janë pikërisht ato që mësova nëpër udhëtime.

Thënë më saktë, përherë kam udhëtuar si i çmendur, qysh në rini. Por kohët e fundit kisha ndjesinë se po jetoja në aeroporte e hotele dhe se ndjenja e aventurës po ia linte vendin një mërzitjeje të thellë. Kur ankohesha ngase nuk mund të rrija shumë në një vend, njerëzit çuditëshin: “Por të udhëtosh është shumë mirë! Sikur të kisha pará për të udhëtuar edhe unë kështu!”.

Të udhëtosh nuk është çështje parash asnjëherë, por është çështje guximi. E kam kaluar një pjesë të madhe të jetës duke udhëtuar nëpër botë si hipí. E, sa para kisha unë atëherë? Hiç. Mezi më dilnin për biletën, e megjithatë mendoj se kanë qenë nga vitet më të mira të rinisë sime: haja keq, flija në stacione trenash, nuk isha në gjendje të komunikoja për faj të gjuhës, varesha nga të tjerët, qoftë dhe për të gjetur një strehë sa për të kaluar natën.

Pasi kalon shumë kohë duke udhëtuar, duke dëgjuar një gjuhë që nuk e kupton, duke përdorur një monedhë, vlerën e së cilës ti nuk e di, duke ecur në rrugë që s'i ke shkelur kurrë, zbulon se Uni yt i vjetër, me të gjitha ato që ke mësuar, është krejtësisht i pavlerë përballë këtyre sfidave të reja dhe fillon të kuptosh që, i groposur thellë në pavetëdijen tënde, ndodhet dikush tjetër që është shumë më interesant, më aventurier, më i hapur ndaj botës dhe përvojave të reja.

Por vjen një ditë kur thua: “Mjaft!”.

- Mjaft! Për mua, të udhëtuarit, është kthyer në një rutinë monotone.

- Jo, nuk mjafton. Asnjëherë nuk do të mjaftojë, - këmbëngul J. - Jeta jonë është një udhëtim i vazhdueshëm, që nga lindja deri në vdekje. Peizazhi ndryshon, njerëzit ndryshojnë, nevojat transformohen, po treni ecën përpara. Jeta është treni, jo stacioni. Dhe ajo që ke bërë nuk është udhëtim, po ndërrim vendesh, që është diçka krejt tjetër.

Mohoj me kokë.

- Nuk ia vlen. Nëse duhet të ndreq një gabim që kam bërë në jetën tjetër dhe jam thellësisht i ndërgjegjshëm për këtë, mund ta bëj këtu. Në atë birucë, vetëm sa i bindesha urdhrave të dikujt që dukej se i njihje planet e Zotit: ty. Sa për të tjerat, i kam gjetur tashmë, të paktën katër veta të cilëve u kërkova falje.

- Por nuk e zbulove mallkimin që ra mbi ty.

- Edhe ti ishe i mallkuar po në atë periudhë. Por a e zbulove dot?

- E zbulova mallkimin tim dhe mund të të siguroj se ishte shumë më i rëndë se yti. Ti u tregove frikacak

një herë, ndërsa unë u tregova i padrejtë në shumë raste. Por kjo më çliroi.

- Nëse dua të udhëtoj në kohë, pse duhet të udhëtoj në hapësirë?

J. qesh.

- Sepse të gjithë e kemi një mundësi shpëtimi, po për këtë duhet të gjejmë njerëzit të cilëve u kemi bërë keq dhe t'u kërkojmë falje.

- Ku të shkoj? Në Jerusalem?

- Nuk e di. Atje ku do ta vendosësh ti. Zbulo se çfarë ke lënë pa mbaruar dhe përfundoje veprën tënde. Zoti do të të udhëheqë, sepse këtu dhe tani është gjithë çka ke jetuar dhe që do të jetosh. Në këtë çast, bota po krijohet dhe po shkatërrohet. Ajo, që ke njohur, do të shfaqet përsëri; ajo, që ke lënë të shkojë, do të kthehet. Mos i tradheto të mirat që të janë dhënë. Kupto çfarë ndodh brenda teje dhe do ta dish se çfarë u ndodh gjithë të tjerëve.

“Mos mendo se kam ardhur të sjell paqe. Kam ardhur të ngre shpatën.”

Shiu më bën të dridhem së ftohti dhe mendimi i parë që më vjen është: “Do t'më zërë ndonjë grip”. Ngushëllohem me mendimin se të gjithë mjekët që kam njohur thonë që gripin e shkakton një virus, jo pikat e ujit.

Nuk arrij të jem këtu dhe tani; kokën e kam lëmsh. Ku duhet të arrij? Ku duhet të shkoj? Po sikur të mos jem në gjendje t'i njoh njerëzit në rrugën time? Kjo me siguri ka ndodhur edhe herë të tjera dhe do të ndodhë përsëri; përndryshe, shpirti im tani do të ishte në paqe.

Kam pesëdhjetë e nëntë vjet që bashkëjetoj me veten time, i njoh disa nga reagimet e mia. Në fillimet e lidhjes sonë, fjalët e J-së dukeshin si të frymëzuara nga një dritë shumë më e fortë se e tija. Unë i pranoja të gjitha pa pyetur dy herë, vazhdoja përpara pa frikë dhe kurrë nuk jam penduar pse kam vepruar kështu. Por koha kalonte, bashkëjetesa u rrit dhe, bashkë me të, erdhi rutina. Edhe pse asnjëherë nuk më ka zhgënjyer për asgjë, nuk mund ta shihja më njëlloj. Ndonëse për hir të detyrimit - të pranuar vullnetarisht në shtator 1992, dhjetë vjet pasi e kisha njohur - duhej t'i bindesha për çdo gjë që më thoshte, tashmë nuk i bindesha me të njëjtën siguri si më parë.

E kam gabim. Nëse zgjedha të ndiqja këtë Traditë magjike, nuk duhej t'i bëja vetes këto lloj pyetjesh tani. Pa dyshim që ka të drejtë, por nuk më pëlqen jeta që bëj dhe tashmë nuk kam më nevojë për sfida. Por Vetëm për paqe.

Duhej të isha i lumtur: kam sukses në profesionin tim, një nga më të vështirët në botë; jam i martuar qysh prej njëzet e shtatë vjetësh me gruan që dua; gëzoj shëndet të mirë; jetoj i rrethuar nga njerëz të cilëve mund t'u besoj; lexuesit tregohen të dashur me mua sa herë i ndesh rrugëve. Pati një kohë kur kjo më mjaftonte, por në këto dy vitet e fundit duket se asgjë nuk më kënaq.

Të jetë thjesht për një konflikt kalimtar? Vallë, nuk mjafton të them lutjet e përhershme, të respektoj natyrën si zërin e Zotit dhe të sodis bukuritë përreth meje? Pse të shkoj përpara kur jam i bindur se kam arritur cakun tim?

PSE NUK MUND TË JEM SI MIQTË E MI?

Shiu bie përherë e më me forcë dhe unë s'dëgjoj asgjë veç zhurmës së ujit. Jam qullur dhe nuk arrij të lëviz. Nuk dua të iki prej këtej sepse nuk di ku të vete, jam i humbur. J. ka të drejtë: po ta kisha arritur vërtet cakun, kjo ndjesi faji dhe frustrimi tashmë do të më kishte kaluar. Por vazhdon. Frikë dhe dridhje. Kur pakënaqësia nuk zhduket, kjo ndodh sepse ka ardhur prej Zotit me një qëllim të vetëm: duhet ndryshuar gjithçka, duhet ecur përpara.

E kam jetuar këtë edhe më parë. Kur nuk pranoja të ndiqja fatin tim, në jetën time ndodhte diçka shumë e vështirë për t'u përballuar. Dhe kjo është frika ime e madhe në këtë çast: tragjedia. Një ndryshim rrënjësor në jetën tonë përherë i lidhur me të njëjtin parim: me humbjen. Kur jemi përballë një humbjeje, nuk ia vlen të rendësh pas asaj që ka ikur; më mirë të shfrytëzosh hapësirën e madhe që është krijuar dhe ta mbushësh me diçka të re. Teorikisht, çdo humbje është për të mirën tonë; praktikisht, kjo ndodh kur e vëmë në dyshim ekzistencën e Zotit dhe pyesim veten: a e meritoj këtë?

Zot, ma kurse tragjedinë dhe do të ndjek planet e Tua!

Tamam kur po mendoja këtë, gjëmoi një bubullimë dhe qielli u ndriçua nga shkrepitja e një rrufeje.

Përsëri frikë dhe dridhje. Një shenjë. Unë këtu, duke u përpjekur të bind veten se gjithmonë jap maksimumin, ndërsa natyra po më thotë pikërisht të kundërtën: ai që është vërtet i angazhuar me jetën kurrë nuk rresht së ecuri. Qielli dhe toka përballen në një stuhë që, pasi kalon, e lë ajrin më të pastër dhe tokën pjellore, por deri

atëherë do të shemben shtëpi, do të bien pemë qindvjeçare, do të përmythen vende përrallore.

Afrohet një njollë e verdhë.

Unë i dorëzohem shiut. Bien rrufe të tjera dhe ndërkohë ndjesia e braktisjes po zëvendësohet nga diçka pozitive, a thua shpirti im, pak nga pak, qenkësh larë në ujin e faljes.

Beko dhe do të jesh i bekuar.

Fjalët dolën natyrshëm nga brenda meje, urtësia që nuk di se e kam, që e di se nuk më përket, por që ndonjëherë shfaqet dhe nuk më lë të dyshoj tek ato që kam mësuar gjatë gjithë këtyre viteve.

Ky është problemi im i madh: pavarësisht çasteve të tilla, vazhdoj të dyshoj.

Njolla e verdhë është para meje. Është ime shoqe, me një nga mushamatë në ngjyrë të ndezur, nga ato që përdorim kur shkojmë për të shëtitur në vise të vështira malore; po të humbasim, do të jetë më e lehtë që të na gjejnë.

- Harrove që kemi një darkë.

Jo, nuk e kam harruar. Dal nga metafizika universale, ku bubullimat janë zëra Perëndish, dhe kthehem në realitetin e qytetit, te vera e mirë, te dashi i pjekur, te biseda e gëzueshme me miqtë që do të na tregojnë aventurat e tyre në një udhëtim që sapo kanë bërë me Harley-Davidson. Duke u kthyer në shtëpi për të ndërruar rrobat, përmbledh me pak fjalë bisedën me J-në atë mbrëmje.

- A të tha ku duhet të shkosh? - më pyet gruaja.

- Angazhohu, - më tha.

- Po kaq e vështirë është kjo? Mos u bëj kokëfortë.

Ngjan më i plakur se ç'je.

Herveja dhe Veronika kanë edhe dy mysafirë të tjerë, një çift francezësh në moshë mesatare. Ma prezantojnë njërin prej tyre si “fatthënës” që e kishin njohur në Marok.

Burri nuk duket as shumë simpatik, as shumë antipatik, vetëm i përhumbur. Megjithatë, nga mesi i darkës, si të kishte hyrë në njëfarë ekstaze, i thotë Veronikës:

- Ki kujdes me makinën. Do bësh aksident.

Mua më lë shije shumë të keqe sepse, sikur ta marrë seriozisht Veronika, frika do të arrijë të ndjellë energji negative dhe gjërat mund të ndodhin tamam ashtu siç e ka parashikuar ai.

- Sa interesante! - them para se të reagojnë të tjerët. - Nuk e vë në dyshim se je në gjendje të udhëtosh përmes kohës, drejt të kaluarës, apo drejt së ardhmes. Pikërisht sonte po flisja me një mik për këtë temë.

- Unë mund të shoh. Kur Zoti ma lejon, mund të shoh. E di kush ka qenë, kush është dhe kush do të jetë çdonjëri prej personave që është ulur në këtë tryezë. Nuk e kuptoj dhuntinë time, por ka kohë që e kam pranuar.

Biseda duhej të ishte për një udhëtim deri në Sicili me miq që kanë të njëjtin pasion për motoçikletat klasike Harley-Davidson; papritur, kjo duket në mënyrë të rrezikshme e afërt me gjërat që nuk dua t'i dëgjoj tani. Sinkroni absolute.

E kam radhën unë të flas:

- Po ashtu, ti e di që Zoti na lë të shohim vetëm kur dëshiron që diçka të ndryshojë.

Pastaj kthehem nga Veronika dhe i them:

- Thjesht ki kujdes. Kur diçka që i takon planit¹ yjor kalon në këtë plan, humbet një pjesë të madhe të forcës. Me një fjalë, jam pothuajse i sigurt që kjo nuk do të ndodhë.

Veronika na shtie prapë verë të gjithëve. Ajo mendon se fatthënësi nga Maroku dhe unë bëjmë masë. Nuk është e vërtetë; ky njeri “sheh” vërtet dhe kjo më tremb. Do të flas më vonë me Hervenë për këtë çështje.

Burri vetëm më vështron; vazhdon me përhumbjen e atij që ka hyrë në një dimension pa e kërkuar, porse tani ka për detyrë ta thotë atë që ndien. Dëshiron të më thotë diçka, por parapëlqen t’i drejtohet sime shoqeje:

- Shpirti i Turqisë do t’i japë burrit tënd gjithë dashurinë e vet. Por do të derdhë gjakun e tij para se t’i zbulojë atë që kërkon.

“Një shenjë tjetër që konfirmon se nuk duhet të udhëtoj tani”, mendoj, duke e ditur që përpiqemi ta interpretojmë çdo gjë duke e lidhur me atë që duam, jo ashtu siç është.

¹ Plan, botë, hapësirë.

Bambuja kineze

Udhëtimi me këtë tren që shkon nga Parisi në Londër, për në Panairin e Librit, është një bekim për mua. Sa herë që shkoj në Angli më kujtohet viti 1977, kur e lashë punën që kisha në një kompani diskografike i vendosur se që nga ai moment do ta fitoja jetesën me anë të letërsisë. Mora me qira një apartament në *Bassett Road*, zura disa miq, studiova vampirologji, njoha qytetin duke shëtitur, pata disa të dashura, pashë të gjithë filmat e programuar dhe, në më pak se një vit, u ktheva në Rio-de-Zhanéjro, pa mundur të shkruaj qoftë dhe një rresht të vetëm. Këtë herë do të rri në qytet vetëm tri ditë. Një takim me lexuesit, darka në restorante indiane dhe libaneze, biseda në hollin e hotelit rreth librave, librarive dhe autorëve. Nuk kam ndër mend të kthehem në shtëpinë time në San Martino deri nga fundi i vitit. Prej këtej, marr një avion për t'u kthyer në Rio-de-Zhanéjro, ku mund të dëgjoj gjuhën e nënës nëpër rrugë, të pi lëng açai² çdo natë dhe të sodis nga dritarja, pa u lodhur kurrë, pamjen më të bukur në botë: plazhin e Kopakabanës.

² Açai është fruta e një palme (*euterpe oleracea*) të Amazonës, i ngjashëm me rrushin, dhe i vishet një gamë e gjerë cilësish. (shën. i përkth.)

Pak para se të mbërrija, një djalë hyn në vagon me një tufë trëndafilash dhe fillon të vështrojë përreth. Është disi e çuditshme, sepse kurrë nuk kam parë shitës lulesh në Eurostar.

- Kam nevojë për dymbëdhjetë vullnetarë, - thotë me zë të lartë. - Çdonjëri do të mbajë një trëndafil kur të arrijmë. Gruaja e jetës sime po më pret dhe do të doja t'i kërkoja dorën për martesë.

Shumë vetë ofrohen, mes tyre edhe unë, po si përfundim nuk u zgjodha. Megjithatë, kur mbërrijmë, vendos ta shoqëroj grupin. Djali tregon një vajzë që ndodhet shkallët e hekurudhës. Një nga një, udhëtarët i japin trëndafilat. Pastaj, ai i shpall dashurinë, të gjithë duartrokasin dhe vajza ul kokën, gjithë turp. Pastaj puthen dhe dalin të përqaftuar.

Një punonjës i ngarkesave komenton:

- Kjo është gjëja më romantike që ka ndodhur në këtë stacion që kur kam filluar punë këtu.

I vetmi takim i programuar me lexuesit zgjati jo më shumë se pesë orë, por më mbushi me energji pozitive dhe më bëri të pyes veten: “Pse kaq shumë konflikte në tërë këto muaj? Nëse përparimi im spiritual duket se ka ndeshur në një pengesë të pakapërcyeshme, a nuk do të ishte më mirë të kisha pak durim? Kam jetuar gjëra që fare pak njerëz rreth meje kanë pasur mundësinë të përjetojnë”.

Para udhëtimit, shkova në një kishëz të vogël në Barbazan-Debat. Aty, i kërkoja Virgjëreshës të më drejtonte me dashurinë e saj dhe të më bënte të aftë t'i shihja të gjitha shenjat që do të më shtynin të rigjeja

vetveten. E di që jam te njerëzit që më qarkojnë, dhe ata janë tek unë. Së bashku kemi shkruar Librin e Jetës, me takimet tona gjithherë të përcaktuara nga fati dhe me duart tona të bashkuara me besimin se mund ta ndryshojmë këtë botë. Gjithsecili bashkëpunon me anë të një fjale, të një fjalie, të një figure, por tekefundit gjithçka është e kuptimshme: lumturia e njerit bëhet gëzimi i të gjithëve.

Përherë do ta pyesim veten për të njëjtat gjëra. Përherë do të na duhet të kemi thjeshtësinë e mjaftueshme për ta pranuar që zemra jonë e kupton arsyen pse jemi këtu. Vërtet është e vështirë të flasësh me zemër, por a është vërtet e nevojshme? Mjafton të kesh besim, të ndjekësh shenjat, të jetosh Legjendën Vetjake tënden dhe, herët a vonë, e kupton se je pjesë e diçkaje, edhe pse nuk mund ta *kuptosh* nëpërmjet logjikës. Tradita thotë se në çastin para vdekjes sonë e kuptojmë arsyen e vërtetë të ekzistencës. Në atë çast lind Ferri, ose Parajsa.

Ferr do të thotë të shohësh pas në atë fraksion sekonde dhe ta dish se ke humbur një mundësi për ta denjësuar mrekullinë e jetës. Parajsë do të thotë të pranosh, në atë çast: “Kam bërë disa gabime, por nuk jam treguar frikacak. E kam jetuar jetën dhe kam bërë atë që duhej të bëja!”.

Pra, nuk është nevoja të parashikoj ferrin tim dhe të vazhdoj të vras mendjen pse nuk jam në gjendje të eci përpara në atë që e kuptoj si “Kërkim shpirtëror”. Duhet të vazhdoj të përpiqem dhe kjo mjafton. Madje edhe ata që nuk kanë bërë gjithçka që mund të kishin bërë janë të falur tashmë; e paguan dënimin e tyre sa ishin gjallë, ishin të palumtur kur mund të ishin në

paqe dhe harmoni. Jemi të gjithë të çliruar, të lirë për të ecur përpara në këtë rrugë të gjatë, që nuk pati fillim dhe nuk do të ketë fund.

Nuk kam marrë me vete asnjë libër. Tek po pres për të zbritur e darkuar me botuesit e mi rusë, shfletoj një nga ato revistat që i gjen përherë në dhomat e hoteleve. Lexoj, pa shumë kureshtje, një artikull për bambunë kineze. Pas mbjelljes së farës, për nja pesë vjet nuk shihet asgjë, përveç një filizi të vogël. Krejt rritja është e nëndheshme; ndërtohet një strukturë komplekse rrënjësh që shtrihet vertikalisht dhe horizontalisht nën tokë. Atëherë, në fund të vitit të pestë, bambuja kineze rritet me shpejtësi të madhe, derisa arrin një lartësi prej njëzet e pesë metrash.

Nuk mund të kisha gjetur tekst më të mërzitshëm për të kaluar kohën. Më mirë të zbres dhe të shoh çfarë ndodh në hollin e hotelit.

Duke pritur orën e darkës, pi një kafe. Monika, agentja dhe mikja ime më e mirë, zbret gjithashtu dhe ulet në tryezën time. Flasim për ca gjëra pa rëndësi. Shoh që është e lodhur duke e kaluar tërë ditën me profesionistët e librit, duke kontrolluar, bashkë me botuesen angleze, çfarë ndodhte në takimin tim me lexuesit.

Kemi filluar të punojmë së bashku që kur ishte ende njëzet vjeç; ishte lexuese entuziaste dhe e bindur se një shkrimtar brazilian mund të përkthehej dhe të botohej jashtë vendit të tij. Monika e la Fakultetin e

Inxhinierisë Kimike, në Rio-de-Zhanéjro, u vendos në Spanjë bashkë me të dashurin e saj dhe filloi të trokiste në dyert e shtëpive botuese, të dërgonte letra duke u shpjeguar se duhej t'i kushtonin vëmendje punës sime. Një ditë, shkova deri në qytetin e vogël katalan ku jetonte, e ftova për një kafe dhe i kërkova që t'i linte ato të gjitha dhe të mendonte më shumë për jetën dhe të ardhmen e vet, meqë asgjë nuk po jepte fryte. Ajo kundërshtoi dhe më tha se nuk mund të kthehej në Brazil me disfatë. U përpoqa ta bindja se kishte fituar, se kishte arritur të mbijetonte (duke shpërndarë pamflete, duke punuar si kameriere) dhe kishte pasur përvojën e rrallë të jetës jashtë vendit. Monika vazhdoi të kundërshtonte. Dola nga kafeneja me ndjesinë se po e çonte jetën dëm, por që kurrsesi nuk do të arrija t'ia ndërroja mendjen, sepse ishte shumë kokëfortë. Gjashtë muaj më vonë, situata ndryshoi krejtësisht dhe, në gjashtë muaj të tjerë, ajo kishte pará të mjaftueshme për të blerë një apartament.

Kishte besuar në të pamundurën dhe, pikërisht për këtë, kishte fituar beteja që ne të gjithë - përfshirë edhe mua - i mendonim si të humbura. Kjo është cilësia e luftëtarit: të kuptojë që vullneti dhe guximi nuk janë e njëjta gjë. Guximi mund të tërheqë frikën dhe miklimin, po forca e vullnetit kërkon durim dhe angazhim. Burrat dhe gratë me forcë të madhe vullneti përgjithësisht janë të vetmuar, sepse përçojnë ftohtësi. Shumëkush mendon se Monika është paksa e ftohtë, por janë shumë larg së vërtetës: në zemrën e saj digjet një zjarr i fshehtë, po aq i fuqishëm sa në kohën kur u takuam në atë kafene. Me tërë ato që ka arritur, vazhdon të ketë entuziazmin e përhershëm.

Kur do t'i tregoja - për t'ia hequr mendjen - bisedën time me J-në, hyjnë në kafene dy botueset nga Bullgaria. Shumë nga pjesëmarrësit e Panairit të Librit janë vendosur në të njëjtin hotel. Flasim për gjëra të kota dhe menjëherë Monika merr përsipër drejtimin e bisedës. Si zakonisht, njëra prej tyre kthehet nga unë dhe më bën pyetjen e pashmangshme:

- Kur do ta vizitosh përsëri vendin tonë?

- Po të arrini të organizoni udhëtimin, javën që vjen. Kam nevojë vetëm për një pritje pas mbrëmjes së firmave.

Të dyja më vështrojnë me dyshim.

BAMBUËJA KINEZE!

Monika kthehet nga unë e çmeritur:

- Pa të shohim agjendën...

- ...po me siguri mund të shkoj në Sofje javën që vjen, - e ndërpres Monikën.

Dhe i them asaj në portugalisht:

- Ta shpjegoj më vonë.

Monika e sheh që nuk po bëj shaka, por botueset ngurojnë. Pyesin nëse do të më pëlqente të prisja pak, derisa të mund të organizonin një promovim të përshtatshëm.

- Javën që vjen, - ngulmoj. - Ose e lëmë për ndonjë rast tjetër.

Atëherë, e kuptojnë se po flas seriozisht. Kthehen nga Monika për hollësitë. Pikërisht në atë çast vjen botuesi im spanjoll. Biseda në tryezë ndërpritet, bëhen prezantimet e domosdoshme dhe vjen pyetja e përhershme:

- Atëherë, kur do të kemi kënaqësinë të të shohim përsëri në vendin tonë?

- Menjëherë pas vizitës sime në Bullgari.
- Kur do të jetë kjo?
- Pas dy javësh. Mund të planifikojmë një mbrëmje firmash në Santiago de Kompostela dhe një tjetër në Vendin Bask. Me pritje për të festuar këto takime, ku do të ftojmë disa lexues.

Botueset bullgare fillojnë të dyshojnë përsëri dhe Monika buzëqesh me zor.

“Angazhohu!”, kishte thënë J.

Bari fillon të mbushet. Në të gjitha panairët e mëdha, qofshin të librave apo të makinerive të rënda, profesionistët zakonisht vendosen në dy ose tri hotele, dhe një pjesë e madhe e marrëveshjeve mbyllen në hollët dhe në darkat si ajo që do të bëhet sonte. Përsëritës të gjithë botuesit dhe pranoj ftesa kur përsërisin pyetjen e përhershme: “Kur do të vish në vendin tonë?”. Përpiqem ta zgjas bisedën aq kohë sa për të shmangur pyetjen e Monikës se çfarë po ndodh. Nuk ka zgjedhje tjetër përveçse të shënojë angazhimet që marr përsipër.

Në një moment, e ndërpres bisedën me botuesin arab për të ditur sa vizita ka shënuar ajo.

- Po më vë në një situatë shumë të ndërlikuar, - përgjigjet Monika në portugalisht, e acaruar.

- Sa?

- Gjashtë vende në pesë javë. A nuk e di që ky panair është për profesionistët e jo për shkrimtarët? S’ke pse pranon asnjë ftesë, tani merrem unë me...

Vjen botuesi portugez dhe nuk mund të vazhdojmë të flasim në gjuhën tonë të fshehtë. Meqë ai nuk thotë asgjë përveç vogëlsirave të përhershme, unë i paraprij:

- Nuk do të më ftosh të vizitoj Portugalinë?

E pranon se ishte afër dhe ka arritur t'i dëgjojë fjalët që po shkëmbeja me Monikën.

- S'po bëj shaka. Do të më pëlqente shumë të organizoja një mbrëmje firmash në Guimaraes dhe një tjetër në Fatima.

- Kur të vijë koha, nuk mund të anulohet. Ti e di...

- Nuk do ta anuloj. Të premtoj.

Ai pranon dhe Monika e vë në agjendë Portugalinë: edhe pesë ditë të tjera. Më në fund, botuesit e mi rusë - një burrë e një grua - afrohen dhe na përshëndesin. Monika merr frymë e lehtësuar. Është çasti që të më tërheqë në restorant.

Tek po presin taksinë, më merr mënjanë.

- Mos je çmendur?

- Që prej shumë vitesh, siç e di. A e di historinë e bambusë kineze? Kalon pesë vjet në gjendje filizi, duke zhvilluar vetëm rrënjët e saj. Dhe pastaj, për një kohë shumë të shkurtër, rritet njëzet e pesë metra.

- E ç'lidhje ka kjo me atë çmenduri që sapo e pashë?

- Më vonë të tregoj bisedën që bëra përpara një muaji me J-në. Por e rëndësishme tani është se pikërisht kështu më ka ndodhur: investova mund, kohë dhe energji, u përpoqa ta ushqeja procesin e rritjes me shumë dashuri dhe shumë përkushtim dhe asgjë nuk ndodhte. Nuk ndodhi asgjë për vite të tëra.

- Si nuk ndodhi asgjë? Nuk e kupton kush je?

Vjen taksia. Botuesi rus hap derën që të hipë Monika.

- Flas për anën shpirtërore. Mendoj se jam një bambu kineze dhe se ka arritur viti im i pestë. Ka

ardhur koha që të ngrihem përsëri. Më pyete nëse jam çmendur dhe t'u përgjigjja me një shaka. Por në të vërtetë po çmendesha. Fillova të mendoja se asgjë nga ato që kisha mësuar nuk zinte rrënjë.

Gjatë një fraksioni sekonde, menjëherë pas mbërritjes së botueseve bullgarë, ndjeva praninë e J-së diku afër meje dhe sakaq i kuptova fjalët e tij, ndonëse ky *insight*³ kishte ndodhur pasi shfletova një revistë kopshtarie në çaste mërzie absolute. Mërgimi im i vetimponuar që, nga njëra anë, më bëri të zbuloja gjëra shumë të rëndësishme te vetja, pati edhe një efekt negativ shumë të rëndë: vetmia u kthye në ves. Universi im ishte kufizuar me ca pak miq nëpër male, përgjigjet e letrave dhe posta elektronike, dhe me iluzionin se krejt pjesa tjetër e kohës ishte e imja. Me një fjalë, një jetë pa problemet e zakonshme që dalin nga bashkëjetesa me njerëz të tjerë, nga kontakti njerëzor.

Por, a është kjo që po kërkoj? Një jetë pa sfida? E ku është e mira e kërkimit të Zotit jashtë njerëzve?

Njoh shumë vetë që e kanë bërë. Një herë, pata një debat serioz dhe njëkohësisht qesharak më një murgeshë budiste që kishte kaluar njëzet vjet e ngjuar në një shpellë të Nepalit. E pyeta çfarë kishte arritur. “Një orgazëm shpirtërore”, u përgjigj. I thashë se ka mënyra më të lehta për të arritur orgazma.

Kurrë nuk do të isha në gjendje ta merrja atë rrugë, nuk është në horizontin tim. Thjesht nuk mundem; nuk do të mundja ta kaloja pjesën tjetër të jetës duke kërkuar orgazma shpirtërore, ose duke soditur lirin e

³ *Insight*, nga anglishtja, do të thotë të shohësh brenda vetes.

kopshtit të shtëpisë sime e duke pritur që urtësia të vijë nëpërmjet soditjes. J. e di këtë dhe më nxiti ta bëja udhëtimin që të kuptoja se rruga ime është e pasqyruar në vështrimin e të tjerëve dhe, nëse dua të gjej vetveten, kam nevojë për këtë hartë.

U kërkoi të falur botuesve portugezë dhe u them se duhet të përfundoj një bisedë me Monikën në portugalisht. Filloj t'i tregoj një histori:

- Një burri i rrëshqiti këmba dhe ra në një gropë. Një prift po kalonte andej dhe burri i kërkoi që ta ndihmonte të dilte. Prifti e bekoj, por pastaj vazhdoi rrugën. Disa orë më vonë, u shfaq një mjek. Burri kërkoi ndihmë dhe mjeku vetëm sa pa nga larg gërvishtjet, shkroi një recetë dhe i tha që të blinte ilaçet në farmacinë më të afërt. Më në fund, u shfaq dikush që nuk e kishte parë kurrë më parë. Përsëri, burri kërkoi ndihmë dhe i panjohuri u hodh brenda në gropë. “Po tani? Kemi ngelur të dy këtu!”. Ndërsa i huaji u përgjigj: “Jo, nuk kemi ngelur. Unë jam prej këtej dhe di si të dal atje lart”.

- Që do të thotë... - thotë Monika.

- Se kam nevojë për të huaj si ai, - i shpjegoj. - Rrënjët e mia janë gati, por mund të eci përpara vetëm me ndihmën e të tjerëve. Jo thjesht me tënden, apo të J-së, apo të sime shoqeje, por të njerëzve që nuk i kam parë kurrë. Jam i sigurt. Kjo është arsyeja pse kërkova një pritje në fund të mbremjeve të firmave.

- Asnjëherë nuk je i kënaqur, - ankohet Monika.

- Dhe pikërisht për këtë më adhuron, - i përgjigjem me një buzëqeshje.

Në restorant, flasim për gjëra të ndryshme, festojmë disa arritje dhe përpiqemi të konkretizojmë disa hollësi. Duhet ta kontrolloj veten për të mos ndërhyrë shumë, sepse është Monika ajo që vendos për të gjitha gjërat që kanë të bëjnë me botimin. Por, dikur, bëhet përsëri pyetja, këtë herë drejtuar asaj:

- Kur do të mund sigurohemi për vizitën e Paulos në Rusi?

Monika fillon t'u shpjegojë që agjenda ime është shumë e ndërlikuar, ngase kam një sërë angazhimesh, duke filluar nga java që vjen. Dhe në këtë çast e ndërpres:

- Përherë kam pasur një ëndërr. Jam përpjekur ta realizoj dy herë dhe nuk kam mundur. Po të më ndihmoni, do të vij në Rusi.

- E çfarë ëndrre është kjo?

- Ta përshkoj Rusinë me tren dhe të arrij në Oqeanin Paqësor. Mund të ndalojmë në disa vende dhe të organizojmë edhe mbrëmje firmash. Kështu nderojmë edhe ata lexues që asnjëherë nuk kanë mundësi të shkojnë deri në Moskë.

Sytë e botuesit tim shkëlqejnë nga gëzimi. Po fliste pikërisht për vështirësitë në rritje të shpërndarjes në një vend aq të madh, me shtatë zona të ndryshme kohore.

- Është një ide shumë romantike, shumë prej bambuje kineze, por aspak praktike, - qeshet Monika.
- Ti e di që nuk mund të të shoqëroj ngaqë sapo kam lindur një fëmijë.

Botuesi, megjithatë, është i entuziazmuar. Kërkon kafën e pestë për atë natë, shpjegon se do të merret me të gjitha, se zëvendësja e Monikës mund ta

përfaqësojë, se nuk ka pse shqetësohet fare: gjithçka do të shkojë mirë.

Plotësoj kështu agjendën për dy muaj rresht me udhëtime, çka sjell si pasojë që një sërë njerëzish janë të lumtur, por të merakosur, sepse do t'u duhet t'i organizojnë të gjitha shpejt e shpejt, një agjente dhe njëkohësisht mike që më vështron me dashuri dhe respekt dhe një mësues që nuk është këtu, por që e di se jam angazhuar edhe pa e kuptuar se çfarë më ka thënë. Është një natë e ftohtë dhe parapëlqej të kthehem më këmbë fillikat në hotel, i trembur nga vetja, porse i gëzuar ngase tashmë nuk mund të kthehem mbrapsht.

Dhe ishte pikërisht ajo që doja. Po të besoja se do të fitoja, edhe fitorja do të besonte tek unë. Asnjë jetë nuk është e plotë pa një grimë çmendurie. Ose, duke përdorur fjalët e J-së: kisha nevojë të rifitoja mbretërinë time. Po të isha në gjendje të kuptoja çfarë ndodhte në botë, atëherë do të isha në gjendje të kuptoja çfarë më ndodhte mua.

Në hotel ka një mesazh nga ime shoqe, e cila thotë se nuk ka mundur të më gjejë dhe më kërkon që t'i telefonoj kur të mundem. Zemra fillon të më rrahë me të shpejt, sepse pothuajse asnjëherë nuk më telefonon kur jam në udhëtim. I telefonoj në çast. Sekondat ndërmjet një sinjali dhe tjetrit më duken pa mbarim. Më së fundi përgjigjet:

- Veronika ka pësuar një aksident të rëndë me makinë, por është jashtë rrezikut, - thotë e shqetësuar.

E pyes nëse mund t'i telefonoj tani, por përgjigjja është jo. Veronika është në spital.

- Të kujtohet fatthënësi?

Po, më kujtohet! Parashikoi diçka edhe për mua. E mbyllim dhe, aty për aty, i telefonoj Monikës. E pyes a kam pranuar ndonjë vizitë në Turqi.

- Nuk i mbake mend ftesat që pranove?

I them se jo. Isha si në eufori kur fillova t'u them "po" të gjithë botuesve.

- Po, a i di angazhimet që ke marr përsipër, apo jo? Ende mund të anulohen, po të duash.

I them se jam i kënaqur me angazhimet, nuk është puna aty. Në atë orë të natës është e vështirë t'i shpjegoj atë çështjen e fatthënësit, parashikimin, aksidentin e Veronikës. Ngul këmbë që Monika të më thotë nëse kam pranuar ndonjë veprimtari në Turqi.

- Jo, - përgjigjet. - Botuesit turq janë vendosur në një hotel tjetër. Përndryshe...

Qeshim të dy.

Mund të fle i qetë.

Feneri i të huajit

Pas pothuajse dy muajsh duke shtegtuar, gëzimi është kthyer, por çdo natë pyes veten a do të vazhdojë të jetë me mua kur të kthehem në shtëpi. A po bëj vërtet atë që duhet, në mënyrë që bambuja kineze të rritet? Përshkova gjashtë vende, u takova me lexuesit, u kënaqa, largova përkohësisht një depresion që kërcënonte të ngulitej, por diçka më thotë se ende nuk e kam rifituar mbretërinë time. Asgjë nga ato që kam bërë nuk është shumë e ndryshme nga udhëtimet e viteve të mëparshme.

Tani mbetet Rusia. Po pastaj, çfarë do të bëj? Të vazhdoj të marr përsipër angazhime për të shkuar më tej, apo të ndalem e të shoh cilat janë rezultatet?

Ende nuk kam arritur ndonjë përfundim. Vetëm di që jeta pa një kauzë është jetë pa fryte. E nuk mund të lejoj që kjo të më ndodhë. Po të jetë e nevojshme, do të udhëtoj gjithë pjesën tjetër të vitit.

Jam në qytetin afrikan të Tunizit. Konferenca do të fillojë pas pak dhe - falë Zotit - salla është e mbushur. Do të prezantohet nga dy intelektualë vendas. Në takimin e shkurtër që patëm më parë, njëri prej tyre më tregoi një tekst prej dy minutash; tjetri kishte shkruar një disertacion prej gjysmë ore mbi veprën time.

Me shumë takt, koordinatori i thotë se është e pamundur që ta lexojë disertacionin, meqenëse veprimtaria nuk duhet të zgjasë më shumë se pesëdhjetë minuta. E marr me mend sa shumë duhet të ketë punuar për tekstin, po koordinatori ka të drejtë: gjendem në Tuniz për të pasur kontakt me lexuesit. Bëhet një debat i shkurtër, thotë se nuk dëshiron më të marrë pjesë dhe ikën.

Fillon konferenca. Prezantimet dhe falënderimet zgjasin jo më shumë se pesë minuta, dhe tani e kam pjesën tjetër të kohës për një dialog të hapur. Them se nuk jam aty për t'u shpjeguar gjëra dhe se do të më pëlqente që veprimtaria të mos ishte një prezantim konvencional, por të kthehej në një bashkëbisedim.

Një vajzë e re bën pyetjen e parë: Çfarë janë shenjat për të cilat flet aq shumë në librat e tu? I shpjegoj se është një gjuhë shumë vetjake që e krijojmë gjatë jetës, përmes fitoreve dhe gabimeve, derisa kuptojmë se kur po na drejton Zoti. Një tjetër pyeti nëse ishte ndonjë shenjë ajo çka më solli në këtë vend të largët. I them se po, veçse nuk hyj më shumë në hollësi. Biseda vazhdon, koha kalon me të shpejtë dhe duhet ta mbyll veprimtarinë. Për pyetjen e fundit, zgjedh rastësisht, mes gjashtëqind njerëzve, një mesoburrë me mustaqe të trasha.

- Nuk dua të bëj pyetje, - thotë. - Vetëm dua të them një emër.

Dhe thotë emrin e një kishe të vogël në Barbazan-Debat, që është në mes të hiçit, mijëra kilometra larg nga ku ndodhem. Dhe, ku një ditë vendosa një pllakë falënderimi për një mrekulli. Është emri i kishës ku

shkova, para këtij pelegrinazhi, për t'i kërkuar Virgjëreshës që të më mbronte gjatë rrugës.

Tashmë nuk di si ta vazhdoj konferencën. Fjalët që vijojnë janë shkruar nga njëri prej prezantuesve që ishin në tryezë:

“Dhe, papritur, Universi dukej se kish ndalur së lëvizuri në atë sallë. Ndodhën aq shumë gjëra... pashë lotët e tu. Pashë lotët e gruas tënde të dashur, teksa ai lexues anonim shqiptoi emrin e një kishëze të humbur diku në botë. Mbetë pa zë. Fytyra jote e qeshur u bë serioze. Sytë e tu u mbushën me lot të druajtur, që drithëronin në skaj të qerpikëve, si të kërkonin falje pse ishin aty pa qenë të ftuara.

“Aty isha edhe unë dhe ndieja një lëmsh në grykë, pa e ditur pse. Kërkova mes publikut gruan dhe vajzën time. Gjithmonë i kërkoj kur ndihem në buzë të diçkaje që s’e njoh. Ishin atje, porse i kishin sytë e ngulur te ty, të heshtura si të gjithë, duke u përpjekur të të mbështesnin më vështrimet e tyre, a thua vështrimet mund ta mbajnë një burrë.

“Atëherë, vura re Kristinën, duke kërkuar ndihmë, duke u përpjekur të kuptonte çfarë po ndodhte, duke kërkuar si e si ta prishte atë heshtje që dukej sikur s’kishte të mbaruar. Dhe pashë se edhe ajo po qante, në heshtje, si në notat e së njëjtës simfoni dhe sikur lotët e të dyve prekeshin mes tyre pavarësisht nga largësia.

“Dhe për sekonda të tëra s’kishte më sallë, as publik, asgjë tjetër. Ti dhe gruaja jote ishit nisur drejt një vendi ku askush nuk mund t’ju ndiqte; ekzistonte vetëm gëzimi i të jetuarit, i shfaqur vetëm nëpërmjet heshtjes dhe emocionit.

“Fjalët janë lot që u shkruan. Lotët janë fjalë që kanë nevojë të rrjedhin. Pa ato, asnjë gëzim nuk ka shkëlqim, asnjë trishtim nuk ka fund. Kështu, pra, faleminderit për lotët e tu.”

Do të duhej t’i thosha vajzës që kishte bërë pyetjen e parë - lidhur me shenjat - se ai ishte një prej tyre, që vërtetonte se unë isha aty ku duhej të isha, në çastin e duhur, ndonëse nuk e kuptoja mirë çfarë më kishte çuar deri aty.

Por mendoj se nuk ishte e nevojshme: duhet ta ketë kuptuar⁴.

Bashkë me gruan po shëtisnim të kapur për dore në pazarin e Tunizit, ndonja pesëmbëdhjetë kilometra nga rrënojat e Kartagenës, e cila në një të kaluar të largët ishte e aftë për t’u përballur me Romën e fuqishme. Folëm për epopenë e Hanibalit, një nga luftëtarët e saj. Romakët prisnin një betejë detare, duke qenë se të dy qytetet ndaheshin vetëm nga disa qindra kilometra det. Po Hanibali u përball me shkretëtirën, kaloi ngushticën e Gjibraltarit me një ushtri shumë të madhe, përshkoi Spanjën dhe Francën, u ngjit në Alpe me ushtarë e elefantë dhe e sulmoi perandorinë nga veriu, në një nga epopetë më të mëdha ushtarake që njihen.

I mundi të gjithë armiqtë gjatë rrugës dhe papritur - pa e ditur deri më sot askush arsyen - u ndal përballë

⁴ Menjëherë pas konferencës, shkova të kërkoja burrin me mustaqe. Quhej Kristian Delemes. Pas kësaj ngjarjeje, shkëmbyem disa mesazhe elektronike, ndonëse nuk u pamë kurrë më. Vdiq më 19 korrik 2009, në Tarbes të Francës. (shën. i aut.)

Romës dhe nuk sulmoi në kohën e duhur. Si rezultat i kësaj pavendosmërie, legjionet romake e fshinë Kartagjenën nga harta.

- Hanibali u ndal dhe u mund, - mendoj me zë të lartë. - Jam i kënaqur që po vazhdoj, edhe pse në fillim ka qenë e vështirë. Po filloj të mësohem me udhëtimin.

Ime shoqe bën sikur s'ka dëgjuar, sepse e ka kuptuar që po përpiqem të bind veten për diçka. Shkojmë në një bar ku do të takohemi me një lexues, me Samilin, zgjedhur rastësisht në pritjen që u bë pas konferencës. I kërkoj që të shmangë të gjitha monumentet dhe pikat turistike dhe të na tregojë ku është jeta e vërtetë e qytetit.

Na çoi te një ndërtesë e bukur ku, në vitin 1754, një vëlla vrau tjetrin. Babai i të dyve vendosi ta ndëronte këtë pallat që të shërbente si shkollë, për të mbajtur gjallë kujtimin e djalit të vrarë. Them se, në këtë mënyrë, do të mbahet mend edhe djali vrasës.

- Nuk është tamam ashtu, - thotë Samili. - Në kulturën tonë, kriminelin e ndan fajin me të gjithë ata që e lejojnë ta bëjë krimin. Kur një njeri vritet, ai që ka shitur armën është gjithashtu përgjegjës para Zotit. Për babanë, e vetmja mënyrë për ta ndrequr atë që konsideronte si gabim të vetin ishte që tragjedinë ta shndërronte në diçka që mund t'u shërbente të tjerëve.

Papritur, gjithçka zhduket: fasada e shtëpisë, rruga, qyteti, Afrika. Bëj një hap gjigant në errësirë, hyj në një tunel që të çon brenda në një bodrum të lagësht. Jam aty përballë J-së, në një nga jetët e shumta që kam jetuar, dyqind vjet para vrasjes që ndodhi në atë

shtëpi. Shikimi i tij është i ashpër, është gati të më qortoje.

Kthehem po aq shpejt në të tashmen. Të gjitha kanë ndodhur në një fraksion sekonde; shtëpia, Samili, ime shoqe dhe zhaurima e rrugës në Tuniz rikthehen. Pse? Përse rrënjët e bambusë kineze ende këmbëngulin për ta helmuar bimën? Gjithçka tashmë ishte jetuar dhe çmimi ishte paguar.

“U tregove frikacak një herë, ndërsa unë jam treguar i padrejtë në shumë raste. Por kjo më çliroi”, kishte thënë J. në Shën Martin. Ai, që kurrë nuk më kishte nxitur të kthehesha në të kaluarën, që ishte krejtësisht kundër librave, manualeve dhe ushtrimeve që të mësonin si ta bëje atë gjë.

- Në vend që të përdorte hakmarrjen, që s’është gjë tjetër veçse dënim, shkolla bëri të mundur që dija dhe urtësia të përçoheshin për më se dy shekuj, - përfundon Samili.

Nuk më shpëtoi asnjë fjalë nga ato që sapo tha, e megjithatë kisha hedhur një hap shumë të madh në kohë.

- Kjo është.

- Kjo është, çfarë? - pyet ime shoqe.

- Jam duke ecur. Po filloj të kuptoj. Gjithçka po fillon të ketë një kuptim.

Ndiej një eufori të madhe. Samili s’kupton asgjë.

- Çfarë mendon islami për rimishërimin? - pyes.

Samili më vështron me habi.

- As që e kam idenë, s’jam erudit, - thotë.

I kërkoj që të informohet. Kap celularin dhe bën disa telefonata. Ne të dy shkojmë në një bar dhe porositim kafe të fortë. Darka e sotme do të jetë me

fruta deti, jemi shumë të lodhur dhe duhet t'i bëjmë ballë tundimit dhe të mos hamë shumë.

- Pata një *déjà-vu*, - i shpjegoj.

- Të gjithë kanë të tilla herë-herë. Është ndjesia e mistershme se e kemi jetuar më parë çastin e tanishëm. S'është e thënë të jesh magjistar për këtë - bën shaka Kristina.

Sigurisht që jo. Por *déjà-vu*-ja nuk është thjesht nga ato çuditë që i harrojmë shpejt, ngaqë asnjëherë nuk ndalemi të diçka që nuk ka kuptim. Tregon që koha nuk ikën. Është një kapërcim në diçka që vërtet është jetuar dhe që po përsëritet.

Samili na është zhdukur nga sytë.

- Në kohën që djali po tregonte historinë e shtëpisë, u hodha në të kaluarën për një të mijtën e sekondës. Jam i sigurt se ndodhi kur ai tha se përgjegjësia nuk është vetëm e vrasësit, por e të gjithë atyre që krijojnë kushtet për krimin. Herën e parë që isha me J-në, më 1982, ai më tha diçka për lidhjen time me babanë e tij. Më pas nuk e preku më kurrë atë temë, dhe unë gjithashtu e harrova. Po para pak çastesh e pashë. Dhe e di se për çfarë po fliste.

- Për atë jetë që më tregove...

- Po. Për atë jetë. Gjatë Inkuizionit spanjoll.

- Ka kaluar tashmë. Nuk ia vlen të vazhdosh ta torturosh veten për diçka që ke bërë para shumë kohësh.

- Nuk po e torturoj veten. Kohë më parë, mësova se, për t'i shëruar plagët e mia, duhej të kisha kurajën për t'u përballur me to. Po ashtu, mësova ta falja veten dhe të ndreqja gabimet që kisha bërë. Megjithatë, që kur jam nisur për udhëtim, ndiej se gjendem përballë një enigme të jashtëzakonshme,

pjesët e së cilës po fillojnë të shfaqen: pjesë dashurie, urrejtjeje, sakrifice, faljeje, gëzimi, hidhërimi. Prandaj dhe jam këtu me ty. Ndihem shumë më mirë, sikur në të vërtetë jam duke kërkuar shpirtin tim, mbretërinë time, në vend që ta kaloj kohën duke u ankuar se nuk po arrij t'i përvetësoj të gjitha ato që kam mësuar.

Nuk e arrij, sepse nuk e kuptoj mirë. Por, kur ta arrij, e vërteta do të më çlirojë.

Samili është kthyer me një libër në arabisht. Ulet me ne, shqyrton shënimet e veta dhe e shfleton me respekt, duke pëshpëritur fjalë arabe.

- Fola me tre eruditë, - thotë më së fundi. - Dy prej tyre thanë se pas vdekjes, të drejtët shkojnë në Parajsë. Megjithatë, i treti më sugjeroi të konsultoja disa vargje të Kuranit.

Vë re se është i përndezur.

- Ja i pari, 2:28: "Allahu do të të bëjë të vdesësh dhe pastaj do të të ringjallë dhe do të kthehesh përsëri tek Ai". Më fal nëse përkthimi im nuk është krejt i saktë, por kështu thotë pak a shumë.

Shfleton si në ethe librin e shenjtë. Përkthen vargun tjetër, 2:154:

- "Dhe, për ata që u flijuan në emër të Allahut, mos thuaj "Kanë vdekur". Jo, ata janë gjallë, ndonëse nuk mund t'i shohësh."

- Tamam!

- Kam edhe vargje të tjera. Por, të them të drejtën, tani nuk ndihem dhe aq mirë për të folur për këto. Parapëlqej të flas për Tunizin.

- Mjafton. Njerëzit kurrë nuk ikin, jemi gjithmonë këtu në jetët tona të kaluara dhe të ardhme. Nëse të intereson, kjo temë del po ashtu edhe në Bibël. Më kujtohet një varg ku Jezusi i referohet Joan Pagëzorit si rimishërim i Eliasit: “Dhe, nëse dëshiron ta pranosh, ky (Joani) është Eliasi që duhej të vinte.” Por ka edhe më shumë vargje lidhur me këtë, - them.

Ai fillon të tregojë disa histori mbi lindjen e qytetit. E kuptoj se ka ardhur koha të ngrihem dhe të vazhdojmë shëtitjen.

Te një nga portat e murit të vjetër është një fener dhe Samili na shpjegon domethënien e tij:

- Ky përbën zanafillën e njëres prej fjalëve të urta më të famshme arabe: “Drita ndriçon vetëm të huajin”.

Na thotë se kjo fjalë e urtë i përshtatet mjaft mirë situatës që po jetojmë tani. Samili ëndërron të jetë shkrimtar dhe përpiqet që të bëhet i njohur në vendin e tij, ndërsa unë, autor brazilian, jam tashmë i njohur këtu.

I shpjegoj se edhe ne kemi një thënie të ngjashme: “Askush nuk është profet në vendin e tij”. Përherë priremi të vlerësojmë atë që vjen nga larg, pa e pranuar kurrë të bukurën që është përreth nesh.

- Megjithatë, - vazhdoj, - herë pas here kemi nevojë të jemi të huaj ndaj vetes sonë. Kështu, drita e fshehur në shpirtin tonë do të ndriçojë atë që duhet parë.

Ime shoqe duket se nuk po e ndjek bisedën. Por, në një moment kthehet nga unë dhe më thotë: